**VENDIM**
**Nr. 480, datë 24.7.2024**

# PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT, NGA MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE TE KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, TË PRONËS SË NDODHUR NË ZONËN KADASTRALE 3426, PJESË E PASURIVE ME NR. 520 DHE NR. 966, ME VENDNDODHJE NË SHISHTUFINË, TIRANË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale te Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, të pronës së ndodhur në zonën kadastrale 3426, pjesë e pasurive me nr. 520 dhe nr. 966, me sipërfaqe të përgjithshme 12 300 (dymbëdhjetë mijë e treqind) $m^2$ dhe sipërfaqe ndërtimore 1 625,9 (një mijë e gjashtëqind e njëzet e pesë presje nëntë) $m^2$, me vendndodhje në Shishtufinë, Tiranë, sipas formularit dhe plan-rilevimit, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij, për nevoja të ushtrimit të aktivitetit administrativ.
2. Komisionit Qendror të Zgjedhjeve i ndalohet të ndryshojë destinacionin e përdorimit të pronës së përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojë ose t'ia japë atë në përdorim të tretëve.
3. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

# 1. FORMULARI I PËRDITËSIMIT TË PRONËS

Institucioni Qendror Shtetëror /Bashkia: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Identifikoi pronën: Panajot Shaho, Specialist në Sektorin e Materialeve Zgjedhore

Supervizoi: Daniela Alimemeti, Drejtor në Drejtorinë e Logjistikës dhe Digjitalizimit

Aprovoi: Majlinda Çelmeta, Sekretar i Përgjithshem (Në Munges dhe me Urdhër)

| Nr. | Zona Kadastr. & Indeksi i Hartes | Nr. Pasurise | Lloji i Pasurisë | Emërtesa e pasurisë / Adresa | Sip. e pasurisë (m2) | Nga Sip. | | Funksioni për të cilin përdoret prona/ pasuria | Institucioni me përgjegjësi administrative/ | përdorues i pasurisë juridik i përdorimit | nventarizuar me VKM | Te dhëna të tjera (Shënime të veçanta) |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Truall (m2) | Ndërtesë (m2) | | | | | |
| 1 | ZK.3426 K-34-88-(236-A) | 520 | Truall | Pjesë e Pronës Nr.84 "Ish-Regjimenti Kimisë" Rr."Myslym Keta",Tiranë | 12180m² | 12180m² | | Administratë | KQZ | KQZ | | |
| | | | | Objekti Nr.1 | | | 556.36m² | Administratë | KQZ | KQZ | | Objekti 1 Kat |
| | | | | Objekti Nr.2 | | | 384.53m² | Administratë | KQZ | KQZ | | Objekti 1 Kat |
| | | | | Objekti Nr.3 | | | 262.51m² | Administratë | KQZ | KQZ | | Objekti 1 Kat |
| | | | | Objekti Nr.4 | | | 342.06m² | Administratë | KQZ | KQZ | | Objekti 1 Kat |
| | | | | Objekti Nr.5 | | | 43.55m² | Administratë | KQZ | KQZ | | Objekti 1 Kat |
| | | | | Objekti Nr.6 | | | 36.89m² | Administratë | KQZ | KQZ | | Objekti 1 Kat |
| | | 966 | Pa Frut | Pjesë e Pronës Nr.84 "Ish-Regjimenti Kimisë" Rr."Myslym Keta",Tiranë | 120m² | 120m² | | Administratë | KQZ | KQZ | | |
| **TOTAL** | | | | | **12300m²** | **12300m²** | **1625.9m²** | | | | | |

Shënim: Sipërfaqja totale do të plotësohet vetëm për prona me shumë komponentë (që përbëhen nga disa pasuri).

# PLAN RILEVIMI PËR PUNIME KADASTRALE

PRONARI: SHTET | DATË: 31/05/2024 | QËLLIMI: PËRDITËSIM / REGJISTRIM

VENDNDODHJA:
BASHKIA: TIRANE | DVASHK/ZVASHK: D.V.A.SH.K-TIRANA RURALE 1 | ZONA KADASTRALE: 3426 | NUMRI PASURISE: 520,966 | INDEX HARTE: K-34-88-(236-A)

TE DHENAT E PASURISE
LLOJI PASURISE: TRUALL | SIP. E TRUALLIT **S = 12300 m²** | SIP. E GJURMËS SË NDËRTIMIT **S = 1625.9 m²** | NR.KATEVE 1 KAT | NR.PEMËVE___

Y = 487581.366
X = 4581855.040

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE

Y = 488265.872
X = 4581855.040




Y = 487581.366
X = 4581341.957

SH: 1:2500

Y = 488265.872
X = 4581341.957

| Nr. | ORIENTIMI | PERDORIMI | TIPI KUFIRIT | KUFITARI | ID/NIPT | SHENIME TE REALIZUESIT |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | VERI | | | PAS 520 | | |
| 2 | LINDJE | | | PAS 520 | | |
| 3 | JUG | | | PAS 520, PAS 966 | | |
| 4 | PERENDIM | | | PAS 966 | | |

REALIZOI PER SUBJEKT PRIVAT:

EMRI: ONI BRAHO

LICENCA: NR.7484/3 DATE 30.12.2022

KOMPANIA: G-O PROJEKT

NIPT: L71403020P

Oni Braho

Digitally signed by Oni Braho
Date: 2024.06.03 11:52:55 +02'00'

NENSHKRIMI/VULA _____

REALIZOI PER ASHK:

SPECIALISTI: ____

DVASHK: TIRANA JUG

NENSHKRIMI: _____

KONFIRMOI:

PERGJEGJESI/DREJTORI: ____

NENSHKRIMI / VULA: _____

TEKNOLOGJIA E MATJEVE: T, Z, O, G

Kode per teknologjine e matjeve: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash;

PERCAKTIMI KUFIRIT: HK

Kode per percaktimin e kufirit: P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie; HK-Harta Kadastrale;

SHENIME TE VECANTA:

PRONARI/BASHKEPRONARET-DEKLARIM MBI MARREDHENIET ME KUFITARET:

EMRI: SHTET

NENSHKRIMI